

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ISTANBUL DONER” sh.p.k**

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

**Z. Ersin Bakir**, i datelindjes 09.08.1984, i biri i Husamettin-it dhe i Edibe-s, lindur ne Antakya/Turqi dhe banues ne Ataturk Mah. Muammer Akso Cad. No 8, Hatay, Samandag/Turqi, identifikuar me pasaport nr. U36561016 dhe nr personal turk 18806082496, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Z. Mehmet Soy**, i datelindjes 01.06.1987, i biri i Necdet-it dhe i Semiye-s, lindur ne Samandag/Turqi dhe banues ne Sivas Sehitler Cad. Hatay, Samandag/Turqi, identifikuar me pasaport nr. U33553286 dhe nr personal turk 19589066048, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “ISTANBUL DONER” sh.p.k**

Sot me date **25.06.2024**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themellojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**Kreu I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**

**Objekti i shoqerise**

Shoqeria Tregtare “ISTANBUL DONER” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Aktivitet ne sherbimin e ushqimit te shpejt ( Fast Food )

**Neni 2**

**Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “ISTANBUL DONER” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet Njësia Administrative 2, Rruga Myrtezim Këlliçi, Ndërtesa 1/1, Hyrja 3, Kodi Postar 1017, Tirane

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

**Neni 3**

**Forma Juridike**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortaket do ta pershtasin Aktin e Themelimit



- dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
  4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II** **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

### **Neni 4**

#### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

## **Kreu III** **KAPITALI THEMELTAR**

### **Neni 6**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njeqind mije) Leke**. 2 (dy) kuota gjithsej.

#### **Ortaket e shoqerise jane:**

1. **Ersin Bakir**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;
2. **Mehmet Soy**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

## **Kreu IV** **PERSONALITETI JURIDIK**

### **Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

## **Kreu V** **ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria do te administrohet nga administratorët **Ersin Bakir** dhe **Mehmet Soy** te cilet perfaqesojn shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje. Te 2 (dy) administratorët perfaqesojne shoqerine ne marredheniet me te tretet pa qene te kufizuar ne tagrin e tyre, te cilet vec e vec administrojne dhe perfaqesojne shoqerine edhe me bankat e nivelit te dyte me firme personale dhe jo te perbashket.

Administratorët mund t'i delegojne kompetencat e tyre me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

### **Kreu VI DISPOZITA TE TJERA**

### **Neni 9**

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.

Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

### **Ortakët Themelues**

**Ersin Bakir**

  
ERSIN BAKIR

**Mehmet Soy**

mehmet soy  
